

LIGJ
Nr. 73/2014
PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9126, DATË 29.7.2003, "PËR
PËRDORIMIN CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE DHE LËNDËVE PIROTEKNIKE DHE
FISHEKZJARRË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9126, datë 29.7.2003, "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

1. Kudo në ligj, emërtimet "Ministria e Rendit Publik" ose "Ministria e Brendshme" zëvendësohen me emërtimin "ministra përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike".
2. Kudo në ligj, emërtimi "Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës" zëvendësohet me emërtimin "ministra përgjegjëse për energjinë dhe industrinë".

Neni 2

Në nenin 3, pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

"12. "Vërtetim besueshmërie" është akti administrativ i organit përgjegjës të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, ku dokumentohet procesi i verifikimit të të dhënave të individit në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të të gjitha institucioneve shtetërore."

Neni 3

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

- a) Në pikën 1, pas fjalëve "Ministria e Mbrojtjes" shtohen fjalët "pasi personi juridik apo fizik të jetë pajisur me vërtetim besueshmërie të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike".
- b) Në pikën 3, pas fjalëve "Ministria e Energjisë dhe Industrisë" shtohen fjalët "pasi personi juridik apo fizik të jetë pajisur me vërtetim besueshmërie të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike".

Neni 4

Në nenin 7/1, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike kontrollon, verifikon, ndjek zbatimin e rregullave të magazinimit e përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve, si dhe përcakton me rregullore të veçantë mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit e përdorimit të tyre."

Neni 5

Në nenin 8, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Ministria e Mbrojtjes dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike të dhënat e subjekteve të regjistruara në regjistrin shtetëror për lëndët plasëse."

Neni 6

Në nenin 9, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat për dhënien e licencës ose autorizimit për prodhimin, importimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, përdorimin, asgjësimin e lëndëve plasëse, si dhe për dhënien e vërtetimit të besueshmërisë."

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8649, datë 30.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani